

VENDIM
Nr.801, datë 17.4.2009

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË OPERATORIT TELEVIZIV PRIVAT
VENDOR “TV ORA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizionë”, të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht në datën 4.3.2009, sipas vendimit nr.779, datë 25.2.2009 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit juridik “Ora” sh.p.k. për televizionin privat vendor “TV ORA”, me nr.licence 084/TVL, për zonën e qarkut të Vlorës.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Licencave, Drejtoria Teknike, Drejtoria Ekonomike për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)